



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

Datë 21/08/2026

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Sistemim perroi Sheh mbrojtje nga gerryerjet dhe permbytjet si dhe rehabilitim urban i zones perreth.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)PUNE
NDERTIMI: **45000000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT:

74,994,603 (shtatedhjetë e kater milion e nenteqind e nentedhjetë e kater mije e gjashteqind e tre) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit që prokurohet**.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar: "1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare²", gjithashtu dhe bazuar në legjislacionin e fushës në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2 Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025** dhe **2026**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

• Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - *Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore*
 - *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
 - *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës*
 - *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 - *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - *Situacionin përfundimtar të objektit*
 - *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - *Aktin e Kolaudimit të objektit*

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi:

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së

bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës

së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet tëparaqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullorespër kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.P-1 (Punime germimi e toke)* **Niveli A**
 - *N.P-4 (Rruge,autostrada,mbikalime,)* **Niveli A**
 - *N.P-5 (Punime nentokesore, ura vepra,)* **Niveli A**
 - *N.P-7 (Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,)* **Niveli C**
 - *N.P-9 (Punime dhe mrojtje lumre,)* **Niveli C**
 - *N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)* **Niveli C**
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.S.-1 (Punime per prishjen e ndertimeve)* **Niveli A**
 - *N.S.-9 (Punime strukturore speciale ,)* **Niveli C**
 - *N.S.-10 (Shtresa dhe mbistruktura infrast,)* **Niveli C**
 - *N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)* **Niveli C**
 - *N.S.-20 (Shpime gjeologo-inxhinier,)* **Niveli A**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e liçencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) liçencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e liçencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe

procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Sipas zerave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Sipas zerave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.	Sipas zerave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-7	Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NP-12	Punime të Inxhienerisë mjedisore	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NS-1	Punime për prishjen e ndertimeve	Sipas zerave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NS- 9	Punime strukturore speciale.	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NS- 10	Shtresa dhe mbistruktura speciale.	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NS-18	Punime topogjeodezike.	Sipas zerave të preventivit	C	51-100 milion leke
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.	Sipas zerave të preventivit	A	0-20 milion lekë

2.3.3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm.

- Libreze pune (përkatëse)
- C.V (përkatëse)
- Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi:

Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe në bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

• Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili struktura)
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafit teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V. dhe deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.4.1. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeoteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura/Rruga ura)**

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, mekanik, hidroteknik, topograf/marksheider, gjeolog, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2,

kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4., dhe 2.3.4.1. të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punimeve ndërtimore në objekt, duke siguruar që çdo zë i preventivit të zbatohet sipas projektit, specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit. Ky profil është i domosdoshëm për menaxhimin e proceseve ndërtimore në kantier, verifikimin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, koordinimin me disiplinat e tjera dhe ndjekjen e ecurisë së objektit deri në përfundimin e tij;
- **Inxhinieri Mjedisi** është përgjegjës për ndjekjen e masave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, për kontrollin e ndikimeve që mund të krijohen nga aktiviteti ndërtimor, administrimin e mbetjeve, kufizimin e pluhurave, zhurmave dhe ndotjeve të mundshme, si dhe garantimin që punimet të kryhen në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike për mbrojtjen e mjedisit. Ky profil është i rëndësishëm për të siguruar që zbatimi i kontratës të mos cenojë kushtet mjedisore të zonës dhe të minimizojë ndikimet negative gjatë gjithë periudhës së punimeve;
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e punimeve mekanike, përfshirë sistemet HVAC, ventilimin, ngrohje-ftohjen, pajisjet mekanike dhe elementët e tjerë teknikë të parashikuar në projekt. Ky profil garanton që instalimet mekanike të realizohen sipas parametrave teknikë, të jenë funksionale, të sigurt dhe të koordinuara me disiplinat ndërtimore, elektrike dhe hidrosanitare;
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e punimeve hidroteknike dhe hidrosanitare, përfshirë rrjetet e ujësjellësit, kanalizimeve, kullimit, vendosjen e tubacioneve, rakorderive, pusetae, matësve dhe elementëve të tjerë përkatës. Ky profil është i nevojshëm për të garantuar që punimet të kryhen sipas kuotave, pjerrësive, diametrave dhe parametrave të projektuar, duke siguruar funksionimin normal të sistemeve të furnizimit me ujë, shkarkimit dhe drenazhimit;
- **Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për piketimin e objektit, kontrollin e kuotave, azhurnimin topografik gjatë zbatimit dhe përgatitjen e dokumentacionit faktik pas përfundimit të punimeve. Ky profil është i domosdoshëm për vendosjen e saktë të objektit në terren, respektimin e kuotave të projektit, kontrollin e niveleve dhe shmangien e gabimeve gjatë ndërtimit. Roli i tij është thelbësor si në fillim të punimeve, ashtu edhe gjatë fazave të ndërmjetme dhe në përgatitjen e azhurnimit “as built” ;
- **Inxhinieri Gjeolog** është përgjegjës për verifikimin e kushteve gjeologjike të terrenit gjatë zbatimit të punimeve, për identifikimin e mundshëm të shtresave, formacioneve apo kushteve të papërshtatshme që mund të ndikojnë në realizimin e objektit, si dhe për dhënien e vlerësimeve teknike në rast të konstatimit të ndryshimeve nga kushtet e parashikuara në dokumentacionin teknik. Ky profil është i rëndësishëm për të garantuar që punimet që lidhen me tabanin, gërmimet, shtresat natyrore dhe ndërhyrjet në terren të realizohen mbi bazë të vlerësimit profesional;
- **Inxhinieri (Profili Transport/Infrastruktura)** është përgjegjës për zbatimin e punimeve që lidhen me rrugët, akseset, sistemet e jashtme, shtresat rrugore, infrastrukturën

inxhinierike dhe linjat që kalojnë në trupin e rrugës apo në zona të ngjashme infrastrukturore. Ky profil është i nevojshëm për të garantuar zbatimin korrekt të punimeve infrastrukturore, respektimin e kuotave, pjerrësive, shtresave dhe detajeve teknike sipas projektit dhe preventivit;

- **Inxhinieri (Profili Struktura)** është përgjegjës për ndjekjen e punimeve që lidhen me elementët strukturorë të objektit, përfshirë themelet, kolonat, trarët, soletat, muret mbajtëse, elementët betonarme, armimin, betonimin dhe çdo komponent tjetër strukturor të parashikuar në projekt. Ky profil garanton që struktura të realizohet në përputhje me projektin konstruktiv, specifikimet teknike, standardet e zbatimit dhe kërkesat e sigurisë;
- **Stafi Ndihmes/Mbeshtetes/Certifikimet ose Kualifikimet mbeshtetese:**
 - **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis**,
(Për ekspertin e Mjedisit çertifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
 - **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Specialist Per Testimin e Performances se Materialeve/Produkteve te Ndertimit /Inxhinier Materialelesh**,
(Për specialistin e mesiperm duhen paraqitur çertifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
 - **2(dy)** persona, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për ***"Punime në prani/prezence uji"***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
(Për pergjegjesin e Punimeve ne prani uji duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
 - **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si ***"Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin/menaxhimin e dëmeve në mjedis"***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
(Për ekspertin e Demit ne Mjedis duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).

- **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për ***"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"***, ***"Pergjegjes per sigurine"***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"* i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, **1(nje)** persona te certifikuar per ***"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"***, te cilet duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit).

Argumentimi:

Kërkesa për disponimin e ketyre punonjësve që përmbush kriteret për të qenë ***"Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave"***, është një kërkesë në përputhje me natyrën e punimeve, dhe vendodhjes së punimeve, ku njësia e prokurimit vlerëson se, bazuar në ligjin 10 237, dt.18.02.2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*, është i nevojshëm disponimi nga operatorët ekonomikë i **punonjësit** të certifikuar si ***"Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave"***, **me qëllim instruktimin e punonjësve dhe dhënien e ndihmës së parë në rast rrezikimi të jetës së punonjësve të angazhuar në kryerjen e punimeve objekt kontrate.**

- Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij **4 (kater)** persona specialist te certifikuar per ***"Punime ne lartesi"***, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1(nje)** mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet të jete detyruesisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje (konform ligjit për cdo kompani me mbi 15 punetore). Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi:

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjet punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Shenim: Per piken **2.3.5** me nenpikat, si me siper, operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi:

Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per realizimin e kontrates ne mbështetje te gërmes (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar) , si dhe në mbështetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46, pika 1, germa (b). **Sqarojme se, numri i punonjesve eshte percaktuar referuar volumeve te punes qe do te kryhen, afatit te realizimit te kontrates objekt prokurimi si dhe grafikut te punimeve te percaktuar nga autoriteti kontraktor me qellim realizimin me sukses dhe ne kohe te kontrates.**

Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar personeli i nevojshem inxhinierik referuar zerave te preventivit te objektit per realizimin e kontrates ne mbështetje te gërmes “b”, te pikes 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën” si dhe të nenit 44 pika 1 e Ligjit Nr 9643 për “Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe /ose veprimtari instalimi **Autoritetet Kontraktore mund t’u kërkojnë personave**

juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë”.

- Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **65** (*gjashtedhjetë e pese*) **punonjës** për periudhën **3** (*tre*) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatese në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:
 - Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
 - Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **65** punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda _____ **muaj** kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhene garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Nga ky vlerësim është llogaritur që për periudhën e përcaktuar sipas grafikut të punimeve, të kërkuar nga AK për realizimin e punimeve duhen të kryhen nga:

Duke përllogaritur periudhën e kërkuar sipas grafikut të punimeve duhen të jenë në objekt minimalisht 45 punonjës përfshirë: stafin inxhinierik prej 10 inxhinierë (7 dr.teknik + 3 mbeshtetes), ekipin e specialistëve prej 23 specialistë dhe 12 punëtorë të thjeshtë dhe ndihmës.

<u>Perllogaritja e fuqise punetore</u>			
Sipas analizes teknike te nxjerre nga preventivi i paraqitur ne sistem:			
• Sasia e oreve te punes totale	:		=10,300 ore pune
• Sasia e diteve te punes totale	:	10,300/8	=1,288 dite pune
• Kohezgjatja e punimeve ne dite kalendarike	:		=120 dite pune kalendarike
• Kohezgjatja e punimeve ne dite pune faktike	:		=103 dite pune faktike
• Numri i punetoreve ne kantier		10,300/103	=100 veta (specialist dhe punetor)
Shuma totale e punonjesve te nevojshem ne kantier	:		= 100 punonjes

- Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

Specialistit i kerkuar	Numri minimal i kerkuar
• Teknik ndertimi	2
• Teknik topograf	2
• Hidraulik	5
• Karpentier	5
• Hekurkthyes	5
• Betonues	4
• Murator	4
• Gurepunues/Guregdhendes	2
• Saldator	1
• Elektracist	2
• Pllakashtrues	2
• Specialist ndertimi	4

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Specialistet e sipercituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik (ISHTI) të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi:

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa specifike për Stafin e specilisteve është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve, si dhe në përputhje me stafin inxhinierik të kërkuar dhe në bashkëpunim me fuqinë tjetër punëtore do jenë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e përditshme të proceseve të punës në kantier, organizimin e grupeve të punës, kontrollin paraparak të zbatimit të zërave ndërtimore

dhe koordinimin ndërmjet stafit inxhinierik dhe punonjësve të specializuar. Ky punonjës ndihmon në sigurimin e vijueshmërisë së punimeve sipas projektit, preventivit dhe grafikut të miratuar.

- **Teknik topograf** është i nevojshëm për asistimin e inxhinierit topograf/gjeodet gjatë proceseve të piketimit, matjeve në terren, kontrollit të kuotave, aksioneve, niveleve dhe azhurnimeve gjatë zbatimit të punimeve. Ky profil ndihmon në realizimin praktik të matjeve topografike në kantier, në vendosjen e saktë të elementëve të objektit sipas projektit, si dhe në kontrollin e vazhdueshëm të përputhshmërisë ndërmjet gjendjes faktike në terren dhe kuotave të parashikuara në dokumentacionin teknik. Prania e Teknikut Topograf është e rëndësishme për shmangien e gabimeve në pozicionim, nivelim dhe kuotim, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, funksionalitetin dhe saktësinë e zbatimit të objektit.
- **Gurepunues/Guregdhendes** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të punimit të gureve, si pjesë integrale të realizimit të zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.
- **Murator / Suvatues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës, riparimeve, mbylljeve, ndarjeve, suvatimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe përgatitjes së sipërfaqeve për shtresat përfundimtare. Ky profil është i domosdoshëm për zbatimin cilësor të zërave ndërtimorë që lidhen me muraturën dhe trajtimin e sipërfaqeve, duke garantuar rrafshësi, qëndrueshmëri dhe përputhje me detajet e projektit.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për përgatitjen dhe montimin e kallëpeve, elementëve ndihmës të betonimit, skelerive dhe strukturave të përkohshme të punës, sipas kërkesave të projektit dhe kushteve teknike. Cilësia e punës së karpentierit ndikon drejtpërdrejt në formën, dimensionet dhe saktësinë e elementëve betonarme.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për prerjen, kthimin, përgatitjen, montimin dhe vendosjen e armaturës së hekurit sipas projektit konstruktiv. Ky profil është thelbësor për realizimin e elementëve betonarme, pasi gabimet në vendosjen e armaturës cenojnë qëndrueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë strukturore të objektit.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për realizimin e punimeve hidraulike dhe hidrosanitare, përfshirë montimin e tubacioneve, rakorderive, pajisjeve sanitare, rrjeteve të furnizimit me ujë, shkarkimeve dhe elementëve të tjerë përkatës. Ky specialitet garanton funksionimin korrekt të instalimeve hidrosanitare dhe shmangien e defekteve që mund të sjellin rrjedhje, bllokime apo dëmtime të mëvonshme.
- **Saldatori** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të saldimeve speciale në sektore të ndryshme si konstruksione metalike, tuba metalike, etj, si pjesë integrale të realizimit të zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin. OE per Saldatorin e deklaruar duhet të paraqesë certifikaten me EN ISO 9606-1:135 për testimin e saldimit. Per permbushjen e këtij kriteri do të pranohen vetem certifikata të leshuara nga institucione të akredituara ose ekuivalentet e tyre.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.
- **Elektriçisti** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

- **Specialisti i ndertimit** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore dhe ndihmëse që nuk kufizohen vetëm në një profil të vetëm, por që kërkojnë eksperiencë praktike në kantier. Ky punonjës mbështet realizimin e zërave të ndryshëm të preventivit, ndihmon në organizimin e punës dhe kontribuon në përfundimin e proceseve ndërtimore sipas afateve dhe cilësisë së kërkuar.

Autoriteti Kontraktor gjykon se pa këta punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ne kohe dhe cilesi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”* për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **5 (pese)** shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe **5 (pese)** manovratorë (*2 automakinist, 2 eskavatorist dhe 1 buldozerist*), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën 3 muajt e fundit në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**
 - Kontratë pune të vlefshme,
 - Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
 - Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
 - Kartela personale të sigurimit teknik ISHTI të vlefshme të lëshuara të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.10, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve të vleresuara të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin perkates, ne perputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

- Ne perputhje me kërkesat dhe specifikat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe projekt preventiv, për materialet:
 - **Hekur ndertimor;**
 - **Rrjete/tel i zinguar për gabiona etj;**
 - **Hidraulike (tuba ujesjellesi dhe kanalizimesh);**
 - **Tuba betoni-tombino**
 - **Puseta betoni/beton arme etj;**
 - **Materiale-elemente gjelberimi (peme, shkure, bar etj)**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
- **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
- Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me **ISO 9001** (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme / ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti.

Për plotësimin e pikes 2.3.9, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur

Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”

Argumentimi:

Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Kjo kerkese është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitetet për të ofruar furnizim të vazhdueshëm me materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit.

Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar nga Autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mesiperme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Kjo referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimeve të kryera ose ISO, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e ketyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

- Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 12 (dymbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera

Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimumi 20 (njetete) ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri (te vegjel)	2 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer / Rusp me zinxhire me peshe mbi 20ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me kove para dhe krahe mbrapa (mjet teknologjik)	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik)	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Bobcat-Makineri teknologjike (trancher) per frezim dhe hapje kanali me thellesi mbi 50 cm (mjet teknologjik) ekuivalennt Mini Fadrome/ Bobcat me elementin perkates	1 copë	Pronësi ose me qera
Telehender/Pirun teleskopik	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc / Autovinc	2 copë	Pronësi ose me qera
RTV Rimorkiator ose Karrotrec	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes) Hekur - Gome	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes) Hekur - Hekur	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerese sharre Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik/Cekic Hidraulik ose Pneumatik (per eskavatore)	1 copë	Pronësi ose me qera
Pjese speciale qe i montohet eskavatorit: Pllake Vibruese me Ngjeshese Hidraulike dhe Shpues Spiral Hidraulik dhe Aksesore	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te brendshem)	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te jashtem)	2 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Helikopter per lucidim, nivelues	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji 1000-3000 lit	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera

Gjenerator / Motogjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per kthim hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per prerje hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
GPS per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Total Station per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç ne zinxhir (Tipi vin-eskavator) me krahe te gjate me kapacitet ngrites mbi 50T (me grejfer)	1 copë	Pronësi ose me qera
Sistem Well Point (ekuivalent)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni , pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
Nyje Inertesh , pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 65copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 65cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.*
- *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit*

sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet: “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

–“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik...”

–Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim..”.

–Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : “Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës...”Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:
 - Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2023 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)**, ose certifikaten ekuivalente, e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 39001:2012 (per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor)** e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë standartet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

E nevojshme pasi një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO te mesiperme me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

•

b) Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.A(1+2) "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis"-
Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis.

c) Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B() "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis"-
Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis - Grumbullim dhe transport i mbetjeve te Ngurta(Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte), se bashke me Akt Miratimin me kodet 17 01 01; 17 01 02; 17 01 03; 17 01 07; 17 03 02; 17 04 01; 17 04 02; 17 04 05; 17 04 07; 17 04 11; 17 05 04; 17 05 06; 17 05 08; 17 09 04; në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë QKL-te sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, kanale etj*), prishje struktura dhe shtresa rrugore , dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.**

- Operatori ekonomik duhet të dorëzojë **Grafikun e punimeve** në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Gjithashtu në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

- Operatori ekonomik duhet disponojë ose të kenë kontratë shërbimi materiale më një **laborator testimi të betonit**, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve **SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Cdo ofertues duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurise ne Kantier** per punimet ne objekt sipas VKM nr 692 date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe te ruajtjes se shendetit ne pune” i ndryshuar.

Argumentimi:

Kjo kerkese e vendosur gjithashtu ne reference te frymes se ligjit per prokurimin publik dhe konkretisht te nenit 46/1/b, i cili percakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshem, te vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Plan organizimi i punimeve ne objekt krijon bindjen se pasqyrohet ne menyre te qarte nje skedul i detajuar i punimeve te punimeve ne te cilen te identifikohen zerat e punimeve, rradha e tyre, kohezgjatja e punimeve referuar dates se fillimit dhe dates se mbarimit te tyre sipas grafikut te institucionit I cili e ka te domosdoshme ta perfundoje jo me vone se afati i percaktuar gjithë rikonstruksionin, me synimin per te permbushur objektivat dhe per venien ne jete te objektit te kontrates.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes, bashkengjitur DST ne SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Komisioni i Prokurimit